

1. KALAJA E TEPELENËS

Monument kulture Kategoria e I, Kategoria Turizmi i Kulturës

Është ndërtuar në dy faza, të cilat dëshmojnë nga dy objekte të ndryshme, një kala e vogël në brendësi të kalasë së madhe, ndërtuar në shek. XIV dhe kalaja e madhe e ndërtuar nga Ali Pasha në vitet e para të shek. XIX. Kalaja ka tre kulla në formë poligonale, të cilat ndodhen në qoshet veriperëndimore, jugperëndimore dhe juglindore me një sipërfaqe 5.5 ha. Kjo kala ka tre hyrje, të cilat ndodhen: një në anën lindore, një në anën perëndimore dhe një në anën jugore, e cila është dhe hyrja kryesore. Deri më 1820 ka qënë rezidenca e dytë e Ali Pashë Tepelenës.



2. KALAJA E QYTEZËS

Monument Kulture kat. I, Turizmi i Kulturës NjA /Qendër.

Shtrihet mbi kodrën e quajtur në vendin e quajtur Qyteza në veri të fshatit Dukaj. Qyteza ndodhet në 300 m mbi nivelin e detit. Kodra ngrihet në krahun e majtë të luginës së Vjosës dhe i paraprinë një vargu malor. Në rrëzën e saj kalon rruga antike që përshkonte anën e majtë të kësaj luge.

Qyteza ka një sipërfaqe rreth 0.5 ha. Në pjesën më të madhe të saj është e mbrojtur shumë mirë nga natyra dhe gjithashtu është e fortifikuar mjaftë mirë nga muret e fuqishëm në pjesët e hapura natyrore. Në pjesën jugore ndeshim fortifikimin, i cili është rreth 80 m i gjatë dhe 3.60 m i gjerë, ku për ndërtimin e tij janë përdorur blloqe guri në formë kuadratike me përmasa të ndryshme 1.60 x 0.50 x 0.30 m.; 1.30 x 0.50 x 0.40 m. dhe 0.80 x 0.60 x 0.45 m. Një trakt i shkëputur muri ndodhet edhe në anën lindore. Gjatë linjës së mureve vërejmë se muri ka qënë i pajisur me tri kulla, muret e të cilave janë mbështetur në shkëmbin e gdhendur me qëllimin për të shmangur rrëshqitjet.

Në bazë të kontureve të tij, fortifikimi merr formë kuadratike.






Pamje e kodrës së Qytezës



Muri në anën jugore



Planimetria e kalasë

3. KALAJA E LEKLIT

Monument Kulture Kat. I, Turizmi i Kulturës NJA/Qendër

Ngrihet mbi kodrën e quajtur Shën Mëhill në shpatin perëndimor të malit të Golikut. Sipërfaqja e kodrës është shumë shkëmbore, ka një pendencë të theksuar prej lindjes në perëndim. Nga ky pozicion, Lekli kontrollonte ngushticat që lidhin Ilirinë me Epirin, të njohura në Antikitet me emrin ngushticat e Antigonesë. Për nga rëndësia e tyre ato përmenden shpesh në luftërat e fundit të shek. III dhe gjatë shek. II p.e.sonë. Lekli me pozicionin e tij natyral ka patur të tëra kushtet, si taktike ashtu dhe strategjike, për komandimin e hyrjes veriore në luginën e Drinosit.

Rrënojat antike patën tërhequr vëmendjen e udhëtarëve dhe studiuesve të huaj që në shekullin e XIX dhe midis tyre: E.M. Leake, F. Pouqueville dhe E. Isambert, të cilët kanë lënë disa shënime të shkurtra. Në shekullin XX e vizitojnë një numër i madh udhëtarësh: studiues si Hamondi dhe Ugolini. Menjëherë pas krijimit të Muzeut Arkeologjik të Tiranës në vitin 1948, kalaja e Leklit filloi të tërhiqte vëmendjen e arkeologëve shqiptarë, të cilët e në këto rrënoja kërkonin qytetin e Antigonesë, të cilat vazhduan deri në momentin identifikimit të saj nga Dh. Budina në kkodrën e Jermës në Saraqinisht,


mbështetur në 14 tesorat prej bronzi, që mbajnë emrin "Antigoneon", nga ky moment kalaja e Leklit dalëngadalë u la në harresë.

Kalaja e Leklit mendohet se i ka fillesat në shek. IV p.e.sonë. Muri rrethues nuk të jep përshtypjen se mundet të ketë qenë ndonjë fortifikim i mbyllur. Ai ndjek linja të drejta të ndërtuar ndërmjet shkëmbinjve, apo të mbështetur mbi platformat shkëmbore të rrafshuar për këtë qëllim. Skajet e murit lidhen mirë në shkëmbin natyral, të cilat, herë shkëmbi herë blloku, futen si pykë te njëri – tjetri. Akoma nuk është realizuar një konturim i saktë i linjës së mureve.

Muratura është ndërtuar në dy në dy periudha, ku dallohen dy teknika ndërtimi: mure poligonale dhe paralelpipedi me trashësi 3,20 m. Blloqet e gureve kanë përmasa të ndryshme, ata poligonale variojnë nga 0.45 x 0,4 m. deri në 1.20 x 0.50 m., ndërsa blloqet drejtkëndorë kanë përmasa thuhet të njëjta 1.25 x 0.50 x 0.30 m. Teknika e parë, poligonale, haset vetëm në hapësirën e krijuar midis dy shkëmbinjve të lartë e të çrregullt në të majtë të hyrjes, ndërsa stili i dytë, drejtkëndësh izodomik me faqe të rrafshata, haset në tërë vendet e tjerë. Ajo që vihet re në fortifikimin e Leklit ishte edhe përdorimi i blloqeve transversal. Këta blloqe kanë largësi të barabartë 2.7 – 3 m.



Muri poligonal i mbështetur në shkëmb



Skicim i gjurmëve të mureve

4. KALAJA E MATOHASANAJT

Monument Kulture Kat. I, Turizmi i Kulturës, Vendndodhja NJA/Lopës

Ndodhet në majën e një kurrizi shkëmbor, i cili ngrihet në qendër të luginës së Sinanajt, midis shtratit të lumit Vjosa dhe malit të Gribës. Një pozicionim i tillë mundësonte kontrollimin e pellgut gjeografik, por edhe kontrollin mbi rrugën natyrore që vinte nga Amantia dhe përshkonte shpatin lindor të malit për të dalë në Epir dhe Maqedoni. Kalaja e Matohasanajt i përket shek. V p.e.sonë dhe ka gjurmë të vazhdimit të jetës thuhet në çdo periudhë në vijim. Muret e kalasë rrethojnë një sipërfaqe rreth 3 ha, sipërfaqe e përbërë nga rradhë taracash të përshtatshme për banim. Në anët Perëndimore dhe Verilindore nuk ka mure për shkak të terrenit, pasi kurrizi i kodrës është i thepisur dhe i pakalueshëm.

Muret janë ndërtuar në pjesët që kalimi është më i lehtë dhe përfshinë një gjatësi rreth 380 m të fortifikuar, ku trashësia e murit është 3.4 m. Muri është i thatë pa përdorim llaçi. Planimetria e kalasë paraqitet e thjeshtë, ku kemi vetëm një hyrje përmes kullës në anën jugore, pranë saj ndodhen dy kulla të tjera, njëra e rrumbullakët dhe tjetra katrore; linjat e mureve janë të gjata e të drejta, marrin kthesa në varësi të terrenit. Muret rrethuese u përkasin tri periudhave të ndryshme ndërtimi, dy periudhat e para përfaqësojnë periudhën e Antikitetit në këtë qytet, ndërsa periudha e tretë e ndërtimit përfaqëson Antikitetin e vonë.

Periudhës së parë, që datohet në shek. V p.e.sonë, i përket thuhet gjithë linja e mureve, po ashtu edhe hyrja për në kala, e cila ka gjerësi 2.80 m. Kjo periudhë më mirë e përfaqësuar, është në murin e anës veriore. Edhe kulla e rrumbullakët duket se i takon së njëjtës periudhe. Madhësitë e blloqeve në këtë periudhë ndërtimi janë të permasave: 1.4 x 0.95 m ; 0.95 x 1.45 m; 1 x 0.65 m. gjerësia e murit varion nga 3.20 – 3.40 m.


Muri në anën juglindore është pjesa më përfaqësuese e periudhës së dytë, që i përket shek. III p. e. sonë. Në këtë anë muri i periudhës së dytë ka zëvendësuar murin e shëmbur të periudhës së parë. Kjo periudhë përfaqësohet nga tipi i blloqeve katërkëndësh dhe trapezoidal izodomik dhe me faqe të papunuar. Kësaj periudhe i përket kulla e tretë në formë katërkëndore.

Sa i përket periudhës së Antikitetit të Vonë, mendohet se një fragment muri i vogël është përfaqësues i kësaj periudhe.

Në afërsi të kalasë në Matohasanaj janë gjetur dy varre monumentale. Njëri prej këtyre varreve ndodhet vetëm pak metra larg kalasë në anën lindore të saj, ndërsa varri tjetër është gjetur rreth dy km larg nga kalaja.



Muri jugor i Kalasë



Planimetria

5. KALAJA E NIVICËS

Monument Kulture kat. I, Turizmi i Kulturës , NJA Kurvelesh


Ndodhet në majën e një kodre në veri të fshatit Nivicë, e cila, nga banorët vendas quhet kodra e kalasë. Në tre anë të saj kodra rrethohet nga kanionet e Kurveleshit dhe shpatet e saj bien thikë në përrenj. Vetëm një rrugë nga ana e fshatit të çon në kala, është e ndërtuar në një pozicion që ka mbrojtje të madhe natyrore. Në këtë kala dallohen disa periudha dhe teknika ndërtimi.

Në hyrjen e kalasë së Nivicës, në anën jugore të saj, dallohen elementë të një fortifikimi antik. Ky mur qëndron i ngritur në hyrje të kalasë në një gjatësi 6 m, lartësi 1.90 m dhe me një gjerësi 1.80 m është i ndërtuar me blloqe gurësh të punuar, të madhësive të ndryshme. Nuk janë përdorur elementët lidhës të një muri. Në drejtim të lindjes ndodhen disa blloqe gurësh të punuar me përmasa të mëdha (1 x 0.60 m), ndoshta themele, të cilët ndjekin drejtimin e këtij muri që qëndron në këmbë.

Në drejtim të perëndimit dhe të lindjes muri antik vazhdohet nga mure të periudhave të mëvonshme si antikiteti i vonë dhe periudha otomane. Muret e ndërtuara në këtë kala mbyllin një sipërfaqe rreth 1600 m², e cila nga tre anë është e mbrojtur shumë mirë nga terreni shumë i thyer. Në anën perëndimore të kalasë së Nivicës ndodhet vendi i quajtur Plodë, aty ku është gjetur një statuetë prej bronxi e Zeusit rufehedhës dhe gjithashtu ndodhet një linjë muri.



Pamje e kodrës ku ndodhet kalaja e Nivicës



Zeusi rrufe hedhës

6. KALAJA E ZHARRËS

Monument Kulture Kat. I, Turizmi i Kulturës , NjA Qendër

Kjo kala ngrihet në majën e kodrës shkëmbore me të njëjtin emër dhe me lartësi 310 m. Kodra ndodhet në perëndim të qytetit të Tepelenës në anën e majtë të luginës së Vjosës dhe duke u zgjatur nga jugu në veri merr formën e hundës. Nga ky pozicion mund të kontrollohen rrugët që kalojnë në këtë anë të luginës së Vjosës. I pari që e ka vizituar kalanë e Zharrës ka qënë Pouqueville, sipas të cilit kjo kala është vepër e latinëve, më pas është vizituar dhe përmendur nga H. Holland. Nga arkeologët shqiptar ka qënë H. Ceka i pari që e ka vizituar, ka përshkruar gjendjen e rrënojave dhe është shprehur për kohën e ndërtimit të saj. Më pas në vitin 1963 është bërë një ekspeditë informative, me qëllim njohjen e gjendjes së monumentit. Gërmimet e para në këtë kala janë bërë në vitin 1970. Këto gërmime janë drejtuar nga D. Komata.


Kjo kala i përket periudhës së Antikitetit të Vonë (shek. IV – VI e. sonë) dhe mendohet se mund të jetë një nga fortifikimet e Justinianit I për funksionim ushtarak. Muri ndjek format e relievit të kalasë mbi të cilën është ngritur, duke marrë formën e një elipsi të zgjatur me perimenter 410 m dhe rrethon një sipërfaqe prej 0.8 ha. Ai ndiqet në gjithë gjatësinë e tij edhe pse në disa pjesë është dëmtuar dhe rrëzuar plotësisht. Lartësia më e madhe e tij është 2.8 – 2.9 m. Trashësia e murit varion nga 1.6 m. në 1.8 m. Për ndërtimin e tij janë përdorur gurë gëlqerorë mesatar, të cilët janë të punuar ose të pa punuar dhe me forma dhe përmasa të ndryshme. Përmasat më të zakonshme të gurëve janë: 0.26 x 0.13 m ; 0.24 x 0.22 m; 0.28 x 0.26 m; 0.42 x 0.29 m dhe 0.45 x 0.40 m. Muri rrethues është i përfunduar me tre kulla, të cilat ndodhen të vendosura njëra në anën veriore të fortifikimit, njëra në anën verilindore dhe kulla e fundit ndodhet në anën jugore. Dy prej kullave kanë formë katrore, ndërsa kulla në anën jugore ka formë rrethore e cila është edhe më mirë e ruajtur. Hyrja për në kala ndodhet në anën lindore. Përveç elementëve të fortifikimit, në këtë kala është zbuluar edhe një sterë uji në brendësi të saj. Stera ndodhet rreth 20 m larg hyrjes dhe ka përmasa 12.80 m gjatësia, 3.40 m gjerësi dhe 3 m thellësi.




Pamje e kodrës ku ndodhet kalaja Muri



Kulla rrethore në profil në anën jugore



Planimetria e kalasë së Zharrës



Fragment muri në shpatin perëndimor

7. URA METALIKE E LEKLIT

Monument Kulture kat.II , Turizmi Kutlurës , NJA Qendër

Ura metalike ndodhet mbi lumin Drino, aty ku rruga nacionale kthehet për në Përmet. Është vepër inxhinierike e periudhës së Zogut, ndërtuar në vitin 1925 nga një firmë Franceze. Përmasat e Urës janë: 81 m gjatësi, 7.50 m gjerësi, është e ndërtuar me drejtim L-P. Mbahet nga tre këmbë prej betoni.



8. URA METALIKE E DRAGOTIT

Monument Kulture Kat. II, Turizmi i Kulturës , fshati Dragot , Nja Qendër

Ura Metalike ndodhet mbi lumin Vjosë në kthesën e fshatit Dragot. Kjo Urë është projektuar dhe ndërtuar nga studentët e inxhinerisë italiane në vitin 1936 . Në të dy anët e lumit ura është e mbështetur në një platformë të betonizuar. Është Urë e varur me kapriata metalike në formë harku. Ka përmasa: 114 m gjatësi dhe 8 m gjerësi. Rruga ka gjerësi 5 m. Ndërsa parapetet janë nga 1.50 m të gjera dhe janë konstruksion metalik.



9. RRËNOJAT E URËS SË MUÇO HYSËS

Monument Kulture Kat. I, Turizmi i Kulturës , Nja Qendër (I përket Bashkisë Këlcyrë)

10. RRËNOJAT NË URËN ANTIKO-MESJETARE MBI LUMIN VJOSË (Ura e Beçishtit)

Monument Kulture Kat. I, Turizmi I Kulturës , Nja/Qendër

Ndodhet mbi lumin Vojsë kur hidhet për në fshatin beçisht. Kjo urë njihet ndryshe edhe Ura e Beçishtit. Ura ka gjurmë të periudhës romake, gjysma e dytë e shek. I e.sonë, dhe më pas është rindërtuar nga Ali Pasha në fundin e shek. XVIII.

Gjatësia e urës është 260 m dhe drejtimi i saj është Lindje – Perëndim. Dallohen 9 këmbë, 6 nga të cilat funksionale sot. 3 këmbë të urës janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit, njëra prej të cilave

ndodhet në mesin e rrjedhës së lumit. Në 5 këmbë të urës dallohet qartë bazamenti i ndërtuar në periudhën romake.

Bazamentet e periudhës romake kanë formën e rombit 6 këndësh me gjatësi të brinjëve që variojnë nga 5 m deri në 7 m. Blloqet e gurëve kanë përmasa të përafërta me njëri tjetrin, ata kanë trashësi 20 – 35 cm dhe gjatësi 35 – 50 cm.

Gjatë mesjetës ura është rindërtuar. Gjatë rindërtimit duket që është ndërtuar mbi bazamentet romake, por ka edhe bazamente të reja, të cilët janë në formën e rombit. Vetëm dy këmbët anësore të urës kanë formë drejkëndore. Me rindërtimin e saj ura ka shërbyer si pasarelë për kalimin e këmbësorve.

Në periudhat e mëvonshme në të gjitha këmbët që janë funksionale kemi struktura të betonizuara për shkak të vendosjes së pasarelës.

Restaurimi i fundit i urës është bërë në tranversën e saj, e cila është e ndërtuar me elementë druri.



Paraqitja në hapsirë e urës së Beçishtit



Pamje e Urës nga ana perëndimore





Pamje te ures sot , Janar 2018 , komba e trete e ures ka pesuar demtime serioze, kurse e para ekziston vetëm gjurma.

11. UJËSJELLËSI I BËNÇËS

Monument kulture Kat. I, Turizmi i Kulturës , Nja Qendër

Ndodhet mbi lumin e Bënçës rreth 2 km në veri të fshatit me të njëjtin emër. Akuadukti është një vepër Hidraulike e shek. 19, e cila ka shërbyer për të çuar ujin në kalanë e Tepelenës. Ky monument është ndërtuar gjatë periudhës së Ali Pashë Tepelenës, ka pësuar një dëmtim të madh si shkak i një tërmeti në vitet '30 të shek 20 dhe është rindërtuar por o në formën autentike të tij. Monumenti është në formën e një ure, e cila përbëhet nga kanali i ujit, këmbët e monumentit, dhe ura mbi të cilën janë ngritur disa prej këmbëve të tij, në pjesën ku kalon lumi i Bënçës. Kanali i ujit është ndërtuar me gurë të vegjël dhe beton dhe mbahet nga 21 këmbë ose kolona, të cilat po ashtu janë ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç. Këto kolona kanë formë katrore dhe janë të lartësive të ndryshme, lartësi të cilën e marrin në varësi të pjerrësisë që merr kanali. Në pjesën ku kalon kanioni i lumit, këmbët e monumentit janë të ngritura mbi një urë. Ura është e ndërtuar me tre harqe. Kanali i ujit është ndërtuar me beton në të cilin kanë vendosur edhe gurë të përmasave të vogla. Ndërsa këmbët e ujësjellsit dhe ura janë ndërtuar me gurë të përmasave mesatare të lidhur me llaç. Kemi edhe përdorimin e harqeve në pjesët ku monumenti afrohet me faqen e maleve.



Pamje nga ana jugore e monumentit




Ura mbi lumin e bënçës

12. MULLIRI NË FSHATIN NIVICË

Monument kulture Kat I, Turizmi i Kulturës, Nja Qendër

Ndodhet afër lumit të Nivicës në anën perëndimore të këtij fshati. Ky Mulli është i ndërtuar në shekullin 19, ka qënë funksional deri në vitet '90 të shek. 20, ndërsa në ditët e sotme është në gjendje rrënoje. Objekti ka drejtim Lindje – Perëndim dhe vija e ujit i vjen nga ana veriore, ndërsa dalja e ujit bëhet në anën jugore të tij. Gjurmët më të dallueshme dhe më pak të dëmtuara në këtë mulli janë: këmbët e murit që mbajnë kanalin e ujit, tubi metalik që e çon ujin në mulli, guri i mokrrës dhe venddalja e ujit nga mulliri.

Është përdorur teknikë e thjeshtë e ndërtimit të mureve me gure të përmasave të vogëla dhe mesatarë të lidhur me llaç të dobët. Vija e ujit është e ndërtuar mbi disa kolona. Nga mekanizmi i bluarjes dallohet guri i mokrrës dhe venddalja e ujit e ndërtuar me teknikën e harkut.



Pamje e rrënojave të mullirit të Nivicës



Dalja e ujit



Muri mbajtësi kanalit të ujit, shumë të dëmtuara Guri i bluarjes (Mokrra)

13. KISHA E PROFET ILIAS

Monument kulture kat. II, Turizmi i Kulturës , NjA/Qendër

Ndodhet në qendër të fshatit Lekël, pranë shkollës së fshatit. Kjo Kishë është një vepër arkitektonike e shek. 19. Ajo është një ndërtim i thjeshtë e tipit tri nefëshe. Kisha është ndërtuar mbi një bazament guri me përmasa 20 x 17 m, ka drejtim V-J. Muret janë të ndërtuar me gure mesatarë të lidhur me beton. Çatia është e mbuluar me tjegulla. Hyrja për në kishë është në anën veriore të saj. Ambientet e kishës janë: Hajati, Këmbanarja, dhoma e grave, dhoma e burrave dhe Altari. Altarin nga ambienti tjetër e ndanë Ikonostasi, i cili ka përmasa 10.5 m gjatësi dhe 2.5 m lartësi. Ikonostasi është i thjeshtë me punim druri në të cilin janë vendosur ikona të ndryshme me figura shenjtorësh. Dhoma e grave është pak më e ngritur në bazament se ambientet e tjera brenda kishës, për të shkuar aty njihesh me shkallë nga dhoma e meshës.

Në ambientin e kishës dyshemeja mbi bazament është e shtruar me pllakë guri dhe është e rikonstruktuar. Kisha është restauruar në vitin 2001 ku janë bërë disa ndërhyrje restauruese në ambientet e brendshme (dysheme, Ikonostas) dhe në çati. Ikonostasi është i thjeshtë dhe ka 20 ikona me figura shenjtorësh në ballin e tij, ndërsa në pjesën e poshtme të tij janë vendosur 17 ikona. Kisha është e ruajtur në gjendje të mirë, por nga ndërhyrjet restauruese të saj duket që e ka humbur pak kontekstin arkitektonik dhe stilistik të saj.

Kisha e Profetit Ilia është shpallur Monument Kulture i Kategorisë II me vendimet nr. 236 datë 17.05.2010 dhe nr. 301 datë 09.06.2010 nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve – Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit dhe e Trashëgimisë Kulturore.



Pamje nga ana veriore e Kishës



Ikonostasi

14. KISHA E SHËN THANASIT

Monument Kulture kat. II, Turizmi i Kulturës , NjA/Qendër

Ndodhet në juglindje të fshatit Lekësl, te varrezat e vjetra të fshatit. është një ndërtesë kulturi e shekullit 18, e tipit një nefshe me Hajat. Ka drejtim JL – VP. Kisha ka rrethim dhe ambienti përreth saj ka shërbyer si varrezë.

Dallohen tre ambiente të kishës: Hajati, i cili është në pjesën veriore të saj, dhoma e vogël dhe dhoma e meshës. Hyrja për në hajatin e kishës është në anën perëndimore. Në dhomën e meshës është e ruajtur mirë pjesa e absidës. Muret e kishës kanë trashësi 75 cm dhe janë ndërtuar me gurë të përmasave të vogëla dhe mesatarë 20 x 15 cm, 22x14cm, 25 x 30 cm, 37 x 10 cm.

Gjendja aktuale e saj është kthyer në rrënojë. Muret janë të dallueshëm qartë dhe qëndrojnë në këmbë të dëmtuar, edhe Absida është e dallueshme. Çatia është inegzistente dhe vendi ku ndodhej Hajati është shumë vështirë të dallohet. Edhe varret përreth janë në gjendje të keqe, gjithashtu edhe muri rrethues ka shumë dëmtime.

Rrënoja e Kishës së Shën Thanasit është shpallur Monument Kulture i Kategorisë II me vendimet nr. 236 datë 17.05.2010 dhe nr. 301 datë 09.06.2010 nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve –Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit dhe e Trashëgimise Kulturore.



Pamje e rrënojave të kishës nga lindja



Absida

15. KISHA E SHËN MËHILLIT

Monument kulture kat. II, Turizmi i Kulturës , NjA/Qendër

Ndodhet në juglindje të fshatit Lekësl, te varrezat e vjetra të fshatit. është një ndërtesë kulti e shekullit 18, e tipit një nefshe me Hajat. Ka drejtim JL – VP. Kisha ka rrethim dhe ambienti përreth saj ka shërbyer si varrezë.

Dallohen tre ambiente të kishës: Hajati, i cili është në pjesën veriore të saj, dhoma e vogël dhe dhoma e meshës. Hyrja për në hajatin e kishës është në anën perëndimore. Në dhomën e meshës është e ruajtur mirë pjesa e absidës. Muret e kishës kanë trashësi 75 cm dhe janë ndërtuar me gurë të përmasave të vogëla dhe mesatarë 20 x 15 cm, 22x14cm, 25 x 30 cm, 37 x 10 cm.

Gjendja aktuale e saj është kthyer në rrënojë. Muret janë të dallueshëm qartë dhe qëndrojnë në këmbë të dëmtuar, edhe Absida është e dallueshme. Çatia është inegzistente dhe vendi ku ndodhej Hajati është shumë vështirë të dallohet. Edhe varret përreth janë në gjendje të keqe, gjithashtu edhe muri rrethues ka shumë dëmtime.

Rrënoja e Kishës së Shën Thanasit është shpallur Monument Kulture i Kategorisë II me vendimet nr. 236 datë 17.05.2010 dhe nr. 301 datë 09.06.2010 nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve –Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit dhe e Trashëgimise Kulturore.



Pamje e rrënojave të kishës nga lindja



Absida

16. RRËNOJAT E KISHËS SË SHËN KOLLIT

Monument Kulture kat.II, turizmi i Kulturës

(nuk disponojmë foto dhe informacion por do ti komunikojmë me materialin për propozime).

17. BANESA E MYFIT KAÇUBAJT

Monument Kulture kat.II , turizmi i Kulturës, Nja Kurvelesh

Ndodhet ne veri të fshatit Nivicë, brenda hapësirës së Kalasë antike të Nivicës. Është një ndërtesë e fillimit të shekullit XX, 2 katëshe, në formë kuadratike dhe me ballkon në hyrjen kryesore. Ballkoni duket se është ndërtuar kohë më vonë se ndërtimi i shtëpisë. Ka vetëm një hyrje për në banesë, e cila është në katin e parë. Dera kryesore ka formë harku me përmasa 1.85 m lartësi dhe 1.35 m gjerësi. Në katin e parë hyn direkt në koridor dhe ka 3 dhoma, banja dhe koridori i shkallëve që të çon në katin e dytë. Në katin e dytë duket se kanë qënë 2 oda me oxhak, 1 dhomë dhe banja. Dritaret e banesës kanë formë harku. Në koridorin e shkallëve në katin e parë është ndërtuar një frëngji. Katet e shtëpisë kanë qënë ndarë nga dysheme druri. Çatia ka qënë mbyuar me dërrasë guri. Sot kjo banesë është në gjendje rrënoje. Për ndërtimin e mureve janë përdorur gurë të punuar e të skalitur, të vendosur në rreshta horizontal dhe të lidhur me llaç. Gurët për vendosjen në radhë të murit kanë pqrmasa që variojnë: 35 x 9 cm, 45 x 6 cm, 50 x 10 cm. Ndërsa guret e përdorur për qoshe kanë përmasa: 30 x 15 cm, 35 x 18 cm, 40 x 19 cm. Janë përdorur breza prej druri në ngritjen e murit, brezat janë në largësi nga 1m. Dritaret dhe dera kryesore janë të punuara me harqe dhe me paturë.



Pamja ballore e banesës së Kaçupajve



Hyrja e banesës

18. SHTËPIA E SELAM MUSAIT

Monument Kulture kat. I, Turizmi i Kulturës, NjA/Qendër

Ndodhet në lagjen Gjondedaj në fshatin Salari. Kjo banesë është ndërtuar në fundin e shek. 19 dhe lidhet me figurën historike të heroit Selam Musai, rënë në luftën e Vlorës kundër italianve në vitin 1920. Kjo shtëpi ka qënë e banueshme deri në momentin që është bërë Muze, në vitin 1970. Ndërtesa është në formën e shkronjës “L”, me drejtim L-P, me hyrjen kryesore të oborrit në anën lindore të saj. Sipërfaqja e ndërtimit të saj është 142.80 m² dhe ka një rrethim në gjendje jo të mirë. Është ndërtesë 2 katëshe, ku në katin e parë ka shërbyer si Katua dhe, gjithashtu ka patur një Qilar për Verën. Janë dy hyrje poshtë për në Katua, ndërsa hyrja për në Qilar bëhej nëpërmjet Katoit. Në katin e dytë të banesës janë dy ambiente, të cilat kanë shërbyer si Oda me Oxhakë dhe me Banja brenda secila. Sot kjo ndërtesë është në gjendje shumë të keqe dhe e rrënuar. Për ndërtimin e mureve është përdorur një teknikë e thjeshtë ndërtimi, me përodimin e gurëve të vegjët dhe mesatar të lidhur me llac. Kemi edhe përdorimin e brezave të drurëve dhe të tullave gjatë ndërtimit të murit. Në këndet e mureve kemi përdorim të gureve të punuar mirë me skalitje. Edhe në pjesën e dritareve kemi po të njëjtën teknikë. Hyrjet për në katua janë punuar në formë harku.



Pamje e shtëpisë së Selam Musait nga rruga

Këndi i murit me portretin e Selam Musait

19. ZONA E MBROJTUR – KALAJA E TEPELENËS (Distancë 10 M rreth e qark mureve)





Pamje te zonës jashte kalasë



Pamje te zonës brenda kalasë



Kalaja e tepelenës është e populluar Brenda saj , kurse jashtë është pastruar nga ndërtimet në masën 90% .

20. PËR ZONAT E MBROJTURA

- Kisha e shën Thanasit
- Kisha e profet Ilias
- Kisha e Shën Mëhillit
- Ura metalike e Leklit
- Ura metalike e Dragotit (nuk ka foto dhe materiale të tjera plotësuese, do të plotësohen në vazhdimësi).

21. FESTIVALI TIPOLOGJIK I LOJERAVE POPULLORE

Nuk rezulton i regjistruar dhe realizuar ne planet vjetore të aktiviteteve në Bashkinë Tepelenë .

22. SHPELLA MËMA E UJIT, PROGONAT

Monument Natyre ,Turizmi i Interesit të veçantë , Nja/Kurvelesh

Shpella Mema e Ujit ndodhet ne afersi te fshatit Progonat, 1165 m mbi nivelin e detit. Ajo perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e Kretes se siperme qe nuk eshte eksploruar ende mire. Pjesa e njohur eshte e gjate deri ne 800 m dhe e gjere deri ne 6 m. Ajo formon nje labirinth te vertete me plot degezime, puse me uje, zgjerime dhe ngushtime dhe eshte e mbushur me konkrecione me bukuri te rralle. Ka vlere shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ajo eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe vizitohet duke marre rrugen Tepelene-Progonat.

(Koordinatat: 40° 13'15" Veri, 19° 56'5 l" Lindje)



23. STERA E ÇIKËS

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyres NJA/Kurvelesh

Sterra e Cikes, (Shpella me qiell Nivice) (Koordinatat: 40° 11 '34" Veri, 19° 54'19" Lindje)

Ndodhet ne malesine e Kurveleshit, pak me ne lindje te fshatit Gusmar, ne fundin e nje hinke karstike, 890 m mbi nivelin e detit. Thellesia e saj arrin 112 m dhe perbehet nga kater ngushtime. Ky monument eshte i grupit gjeomorfologjik kompleks dhe ka vlere shkencore, didaktike dhe gjeoturistike. Vizitohet duke marre rrugen Tepelene- Progonat- Gusmar.



Pamje nga Sferra e Cikes, (Shpella me qiell Nivice)

24. SHPELLA E LEK PETËS

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyres NJA/Kurvelesh



25. SHPELLA E UJIT DHEMBEL

Monument natyre kat III , Turizmi i interesit të veçantë.



Ndodhet ne afersi te fshatit Lekel, 970 m mbi nivelin e detit. Ajo perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e Kretes se sipërme. Ende nuk eshte eksploruar. Pjesa e njohur eshte e gjate deri ne 603 m, e gjere 4 deri ne 20 m dhe e larte deri ne 4 m. Ky monument, i rendesise lokale, eshte i grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, didaktike dhe gjeoturistike. Vizitohet duke marre rrugen Tepelene -Lekel.

(Koordinatat: 40° 00' 00" Veri, 20° 00' 00" Lindje)

26. VRIMA E SHKËMBIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Gusmar, NJA/Kurvelesh



Ndodhet ne afersi te fshatit Progonat (Rrafshnalta e Kurveleshit), 1110 m mbi nivelin e detit dhe perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e Kretes se sipërme, prane kontaktit me gelqeroret e Kretakut te poshtem. Ende nuk eshte eksploruar. Pjesa e njohur ka pjerresi 20-30° dhe eshte e gjate deri ne 200 m dhe e gjere deri ne 2-8 m. Ky gjeomonument, i rendesise lo-kale, eshte i grupit gjeomorfologjik kompleks dhe ka vlere shkencore, didaktike dhe gjeoturistike. Ajo eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe vizitohet duke marre rrugen Tepelene-Progonat (V-d-28) Shpella e Dragoit-Progonat, (Koordinatat: 40° 11'46" Veri, 19° 54'40" Lindje)

27. UJVARA E PROGONATIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Progonat NJA/Kurvelesh



Ujvara e Progonatit (V-b-40) Kanionet e Gurres, Lekdush, Progonat, (Koordinatat: 40° 13'15" Veri, 19° 57'09" Lindje) Kanionet e Gurres, Lekdush, Progonat dhe Ujvara e Progonatit ndodhen pak me

ne lindje te fshatit Progonat. Ne te, rrjedhin ujrata e Perroit te Gurres se Progonatit. Banoret e quajne "buza e ujit". Ketu, perroi formon kanione dhe ka lartesi rreth 1 000 m mbi nivelin e detit. Uj-vara ka lartesi rreth 400 m, ku uji duke rënë nga kartesia fonnon ngjyra ylberi me pennasa te medha. Shtresezimet horizontale te pakos karbonatike strallore te Jurasikut, gelqeroreve mergelore te Kretakut dhe gelqeroreve copezore te Eocenit ne pjeset e siperme, i japin kanionit dhe ujvarave pamjen e mureve gjigande. Ky monument, i rendesise nderkombetare, eshte i grupit gjeomorfologjik kom-pleks dhe ka vlere shkencore, didaktike dhe gjeoturistike. Vizitohen duke marre rrugen Tepelene-Progonat.

28. SHPELLA E KASARIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Progonat NjA/Kurvelesh

Gjendet pak me ne juglindje te fshatit Progonat, ne shpatin e djathte te lugines se perroit, para ngjitjes se rruges rurale per ne fshatin Golem te Gjirokastrës. Ajo perben nje shpelle karstike ende te pa eksploruar plotesisht te formuar nga procesi i karstit ne shkembinjte karbonatike. Pjesa e njohur eshte e gjate rreth 200 m, gjeresia e hyrjes rreth 2 m, ndersa ne brendesi, gjeresia lekundet nga 2-3 m ne 15-20 m. Ajo ka ngushtime e zgjerime dhe ne fund, edhe nje salle te madhe me lartesi mbi 12 m, qe komunikon me siperfaqen e nepermjet nje oxhaku. Stalaktitet jane te medhenj dhe shume te bukur. Shpella eshte vizituar nga speleologe greke etj, por ata italiane te "Puglia Grotte" dhe "Dauno" kane bere eksplorimin dhe planimetrine e plote te saj ne vitin 1994. Shpella ka vlere shkencore (morfologjike, gjeologjike, speleologjike), didaktike e turistike. Ajo eshte e ruajtur mire dhe mund te vizitohet relativisht lehte duke ndjekur rrugen rurale Progonat-Golem, deri para ngjitjes per ne qafe, prej nga duhet ndjekur ne kembe per rreth 20 minuta lugina e perroit ne te majte te kesaj rruge. (Koordinatat: 40° 11' 58" Veri, 19° 56' 49" Lindje)

29. KANIONET E NIVICËS

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Nivicë NjA/Kurvelesh



Ndodhen ne afersi te fshatit. Ato kane gjatesi deri ne disa km, gjeresi mesatare rreth 15 m, ndersa thellesia arrin deri ne disa dhjetra metra dhe jane formuar nga erozioni i Perroit te Nivices, pjese e atij te Benyes, ne shkembinj karbonatike. Perroi i Nivices, poshte fshatit me te njejtin emer, ka formuar nje gryke me shtrat teper te ngushte, me gjatesi rreth 3 km deri ne pellgun e Merje, vend ku bashkohet me Gurren e Progonatit. Fundi i tij eshte teper i yrregullt, me thyerje ose pragje dhe vrulle, te shoqeruara dhe me forma negative, qe jane gropa dhe brazda te thelluara ne fundin shkembor te kanionit, me pamje ovale ne trajte kazanore, me uje te paster e te kulluar. Uji shkeputet e bie nga lartesi te medha (30-40 m) dhe formon ujevare, si ajo e Guves dhe dy te tjera poshte saj, ku kanioni, ndonese gj ithnje e me i thelle, paraqitet me plot kontra-ste natyrore, rrepara, shtrat te shkallezuar dhe shpella te shumta ne faqen e shkembit. Ato jane shpa-llur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe vizitohen duke marre rrugen Tepelene-Progonat-Nivice.
(Koordinatat: 40° 14'04" Veri, 19° 55'01" Lindje)

30. LUGJET E DHËMBLANIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Dhëmblan NjA/Lopës

Ndodhen prane fshatit Dhëmban te Bashkise Tepelene. Keto forma negative te relievit jane krijuar mbi konet e depozitimeve te gureve e ryakullinave te rrezuara dhe te sjella nga pjesa e sipërme e shpatit te Malit te Gribes. Ujrat i pershkojne ato vetem kur bien shira te rremby-eshem apo bora shkrin shpejt. Ne rastet e tjera, uji humbet ne zgaverimet e te rryarat karstike ne lugje. Forma e ketyre lugjeve eshte e perzgjatur deri ne disa qindra metra, ndersa gjeresia mesatare arrin deri ne rreth 10 m. Ato kane vlera shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike), didaktike, hidrologjike dhe gjeoturistike me rendesi lokale. Ato jane shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe mund te vizitohen duke marre rrugen automobilistike Tepelene – Salari - Dhëmban.
(Koordinatat: 40° 20'4 I" Veri, 19° 51 '47" Lindje)



31. BUZA E BREDHIT, LUZAT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Luzat NjA/Qendër

Gjendet ne jug te qytetit te Tepelenes, ne pjesen lindore te malesise se Kurveleshit. Ajo perben nje rrepire shkembore me lartesi disa qindra metra dhe gjatesi rreth 800 m. Ketu, shkembinjte gelqerore jane prere nga shkeputja tektonike. Ajo eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe vizitohet duke marre rrugen Tepelene-Luzat
(Koordinatat: 40° 13'22" Veri, 20° 01 '31" Lindje)



32. RRAPI I SELAM MUSAIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Natyrës, Tepelenë/Tepelenë



25

(ekziston por është tharë)

33. SHPELLA E MEZHGORANIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Interesit të Veçantë, Mezhgoran NjA/Qendër

Kjo shpelle gjendet ne fshatin Mezhgoran, ne shpatin verior te Grykes se Kelcyres, struktura antiklinale Shendelli-Lunxheri-Bureto, rreth 850 m mbi nivelin e detit. Kjo shpelle karstike eshte formuar nga veprimi i proceseve te karstit ne gelqeroret e Kretakut. Ende nuk eshte eksploruar plotesisht. Pjesa e njohur eshte e gjate mbi 150 m, ndersa gjeresia mesatare arrin deri ne 7-8 m. Ajo eshte horizontale, me ngushtime e zgjerime. Ne tavan, ka mikroforma karstike (stalaktite). Ky gjeomonument, i rendesise lokale, eshte i grupit gjeomorfologjik kompleks dhe ka vlera shkencore, (gjeomorfologjike, gjeologjike), didaktike dhe gjeoturistike. Ajo eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe mund te vizitohet duke ndjekur rrugen automobilistike marre Tepelene-Dragot-Mezhgoran. Me pas, ndiqet rruga kembesore per tek hyrja e shpelles.

(Koordinatat: 40° 18'24" Veri, 20° 07'01" Lindje)



34. SHPELLA E LEKLIT

Monument Natyre Kat. III Turizmi i Interesit të Veçantë, Lekël NjA/Qendër

Shpella e Leklit ndodhet ne afersi te fshatit Lekel, 400 m mbi nivelin e detit. Ajo perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e Kretes se sipërme qe ende nuk eshte eksploruar plotesisht. Pjesa e njohur eshte e gjate deri ne 100 metra, e gjere deri ne 8 m dhe e larte deri ne 6 m. Ky monument, i rendesise lokale, eshte i grupit morfologjik kompleks dhe ka vlera shkencore (gjeologjike, morfologjike, hidrologjike), didaktike, ekologjike, kulturore dhe gjeoturistike. Vizitohet duke marre rrugen Tepelene- Lekel.

35. BURIMET E UJIT TË FTOHTË


Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës, Luzat NjA/Qendër

Gjendet ne te djathte te rruges automobilistike kombetare Tepelene-Gjirokastr, pak pas degezimit te rruges automobilistike per ne Permet. Burimi ne pjesen e sipërme te shpatit te majte te lugines se

Drinosit, ne kontaktin e shkembinjve gelqerore me ata flishore. Ujrat e rreshje-atmosferike qe bien ne pjesen lindore te malesise se Kurveleshit (Buza e Bredhit), nepermjet zga-verimeve e shpellave karstike, depertojne ne thellesi te shkembinjve gelqerore dhe ushqejne kete bu-rim. Shpati ku del burimi eshte i veshur me bimesi natyrore te dushkut dhe shkurreve. Ne afersi te lu-gines, druret e rrepeve jane mjaft te rritur. Zhurma e ujit, gjelberimi, cicerimat e zogjve etj, prej ko-hesh, e kane kthyer kete vend ne mjedis pushimi per udhetaret. Vizitohet me lehtesi pasi eshte prane rruges automobilistike Tepelene-Gjirokaster.

Ka vlera shkencore (hidrologjike, gjeomorfologjike), estetike e turistike. Ato jane shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 , vizitohen duke marre rrugen Tepelene-Gjirokaster.

(Koordinatat: 40° 15' 11" Veri, 20° 03'39" Lindje)



36. TARACA EROZIVE E BENÇËS

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës , Bençë NjA/ Qendër

Gjendet ne luginen e Perroit te Bences, prane fshatit me te njejtin emer. Ajo eshte formuar nga veprimtaria erozive e depozituese mijra vjeyare e Perroit te Bences. Gjatesia e saj eshte mbi 800 m, ndersa gjeresia mesatare eshte 20-30 m. Ajo ndertohet nga material zallor prej gel-qeroresh, por ne shpinen e saj jane grumbulluar edhe materiale yakullore te ardhur nga pjesa e siper-me e shpatit te pjerret te malit. Nga banoret, eshte perdorur per mbjellje te kulturave bujqesore . Tarraca eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 date 20. 12.2002 dhe vizitohet me lehtesi duke marre rrugen automobilistike rurale Tepelene-Bence fshat.


(Koordinatat: 40° 15' 17" Veri, 20° 00'22" Lindje)



37. SHKËMBI I PRERË DUKAJ


Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës , Luzat NjA/Qendër

Ndodhet prane fshatit Dukaj te Bashkise Tepelene. Ai ka forme karakteristike qe dallohet ne mjedisin perreth. Gjatesia e tij eshte rreth 30 m, gjeresia 10-15 m e lartesia rreth 20-30 m. Emrin e ka marre nga banoret, pasi vertet duket sikur e ke prere me mjete prerese (me sepate), por kjo eshte bere nga faktoret tektonike dhe erozive. Eshte shpallur shesh ne mbrojtje me VKM nr. 676 dt. 20. 12.2002 dhe vizitohet duke marre rrugen automobilistike Tepelene- Turan- Dukaj- Shkembii Prere.




38. RRAPI I PROGONATIT

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës , Progonat NjA Kurvelesh




39. RREPET E UJIT TË FTOHTË

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës , Luzat NjA/Qendër



40. LISAT E LUZATIT

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës , Luzat NjA/Qendër



41. RRAPI I HORMOVËS

Monument Natyre kat. III Turizmi i Natyrës ,Hormovë NjA/Qendër

